



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 8, DATË 23.2.2023,
TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT
PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE
KANDIDATËVE NË FLETËT E VOTIMIT NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Neni 98, pika 5 ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për organizimin e hedhjes së shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen, menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumëmemërore në KQZ apo, sipas rastit, në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, është hartuar projektvendimi “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Pas miratimit të vendimit dhe në vijim të fushatave të edukimit që ka marrë KQZ janë vërejtur paqartësi nga ana e zgjedhësve. Qëllimi i këtyre ndryshimeve lidhet me shmangien e pavlefshmërisë së fletëve të votimit. Ky projektvendim përcakton mekanizmin e hedhjes së shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimi për këshillat e bashkisë. Shorti dhe parashorti

do të kryhet në 4 raunde.

1. Në raundin e parë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh në të gjitha zonat zgjedhore.
2. Në raundin e dytë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar listat shumemërorë në më shumë se 31 zona zgjedhore.
3. Në raundin e tretë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar listat shumemërorë deri në 30 zona zgjedhore.
4. Në raundin e katërt përfshihen në short kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë, në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen dy ose më shumë kandidatë. Shorti do të hidhet ndërmjet tyre. Renditja e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit bëhet në raundin e katërt. Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe koalicioneve.”.

Projektvendimi parashikon se numrat e përfshirë në short janë në rend rritës dhe të barabartë me numrin e subjekteve që marrin pjesë në secilin raund. Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në raundin pararendës nuk përfshihen në raundin vijues.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 2023

Nr:

Ora:

V E N D I M

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 8, DATË 23.2.2023, TË
KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR
PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE NË FLETËT
E VOTIMIT NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE"**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja "a", e 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në nenin 2, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si vijon:

"1. Renditja e subjekteve zgjedhore dhe e kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore në fletët e votimit bëhet nga numri më i vogël te numri më i madh, sipas përzgjedhjes rastësore (short) të numrave natyrorë.

2. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë bëhet në katër raunde, si vijon:

a) Në raudin e parë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh në të gjitha zonat zgjedhore.

b) Në raudin e dytë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar listat shumemërore në më shumë se 31 zona zgjedhore.

c) Në raudin e tretë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar listat shumemërore deri në 30 zona zgjedhore.

d) Në raudin e katërt përfshihen në short kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë, në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen dy ose më shumë

Data:

Nr:
Ora:



"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.8,
datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator"

kandidatë. Shorti do të hidhet ndërmjet tyre. Renditja e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit bëhet në raundin e katërt.

Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe koalicioneve.”.

b) Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në fund të fjalisë së parë të pikës 1, të nenit 4, shtohen fjalët “...për secilin raund...”.

ii. Shkronja “a” e pikës 1, ndryshohet si vijon:

“a) Parashorti për secilin raund zhvillohet si më poshtë:”.

iii. Shkronja “b”, e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“b) Shorti për raundin e parë zhvillohet si më poshtë:”.

iv. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) E njëjta procedurë e përcaktuar në shkronjën “b” ndiqet për çdo raund. Numrat e përfshirë në short janë në rend rritës dhe të barabartë me numrin e subjekteve që marrin pjesë në secilin raund. Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në raundin pararendës nuk përfshihen në raundin vijues.”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Data:

Nr:
Ora:



“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.8,
datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator”

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data:

Nr:
Ora:



“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.8,
datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator”